V E N D I M
Nr.372, datë 27.5.2001

PËR FILLIMIN E PROCESIT TË PRIVATIZIMIT E TË RISTRUKTURIMIT DHE PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS E TË STRUKTURËS SË FORMULËS SË PRIVATIZIMIT TË SHOQËRISË ANONIME "SERVCOM" FIER

Në mbështjetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, 7, 8, 9 dhe 12 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë", të nenit 2 të ligjit nr.8707, datë 1.12.2000 "Për privatizimin e shoqërisë anonime "Servcom", të neneve 21 dhe 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 7 të ligjit 8718, datë 19.12.2000 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2001", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shoqëria anonome "Servcom" Fier t'i nënshtrohet procesit të ristrukturimit të plotë.

2. Nga "Servcom" sh.a., të shkëputen Uzina Mekanike Patos dhe Parku i Mallrave Patos. Privatizimi i këtyre njësive do të bëhet në përputhje me legjislacionin e privatizimit të sektorëve jostrategjikë.

3. Fillimin e procedurave për privatizimin e "Servcom", sh.a. Fier. Forma e privatizimit të shoqërisë të jetë ajo e transferimit të së drejtës së pronësisë të aksioneve të saj të tretëve.

4. Stuktura e formulës së privatizimit të aksioneve të kapitalit të shoqërisë të jetë si vijon:

a) Jo më pak se 51 për qind e aksioneve të kapitalit të ofrohen për t'u shitur në lekë. Shuma e aksioneve të mësipërme të kapitalit të transferohet nëpërmjet shitjes me tender të hapur.

b) Jo më shumë se 20 për qind e aksioneve të kapitalit t'u ofrohet punonjësve të shoqërisë me anë të shkëmbimit me bonot e privatizimit, dhënë atyre nga shteti. Procedura e transferimit të bëhet sipas vendimit nr.119, datë 18.3.2000 të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë", kapitulli B pika 1 deri 5, vetëm për punonjësit e shoqërisë. Si punonjës të "Servcom" sh.a. që përfitojnë nga pika "b", quhen punonjësit në çastin e hyrjes në fuqi të ligjit nr.8707, datë 1.12.2000, si dhe punonjësit e njësive të kësaj shoqërie, të dalë në asistencë me vendimin nr.422, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave.

c) Ish-pronarëve të truallit t'u ofrohen aksione sipas vlerës së përfshirë në kapitalin e shoqërisë, në mbështetje të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

5. Formula e privatizimit të aksioneve të kapitalit të shoqërisë dhe madhësia e paketave respektive përcaktohet me urdhër të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

6. Punonjësit që dalin të tepërt nga procesi i ristrukturimit dhe i privatizimit të shoqërisë të cilët deri më datën 30.12.2000 kanë qenë në marrëdhënie pune, të trajtohen për 1 (një) vit me pagën bazë. Shpenzimet që nevojiten për pagat e këtyre punonjësve, të përballohen nga të ardhurat e privatizimit të kësaj shoqërie.

7. Periudha 1 (një) - vjeçare për këta punonjës të njihet si vjetërsi në punë për efekt pensioni dhe të shënohet e tillë në librezën e punës.

8. Të drejtën e trajtimit sipas këtij vendimi e kanë ata punonjës që nuk zhvillojnë veprimtari ekonomike në formën e punësimit ose të vetëpunësimit. Në rast të kundërt, u ndërpritet trajtimi që përfitojnë sipas këtij vendimi.

9. Kontributet e papaguara, së bashku me kamatëvonesat që "Servcom" sh.a. ka ndaj sigurimeve shoqërore deri në datën 30.12.2000, e që arrijnë vlerën 178.185.000 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë) lekë, të shlyhen brenda 30 ditëve nga arkëtimet që do të realizohen nga privatizimi i shoqërisë.

10. Pagesa e punonjësve që dalin tepër nga zbatimi i këtij vendimi të bëhet nga zyrat e punësimit në rrethet përkatëse, pas transferimit të fondit financiar nga "Servcom" sh.a.

11. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Ministria e Financave për nxjerrjen e udhëzimit përkatës dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta